



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.513/16

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykatë në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditëses:

nga Mitrovica të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Av. kundër të paditurës:

” të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Lirije Bajraktari, baza e kontestit: pagesa e pagave përcjellëse në pension si dhe shpërblimit jubilar, në seancën e datës:17.11.2017 konform nenit 148 të LPK-së bjen këtë:

A K T G J Y K I M
- në bazë të pohimit -

- 1. OBLIGOHET** e paditura që në emër të tri pagave përcjellëse dhe një page si shpërblim jubilar t'ia paguaj paditëses shumë të përgjithshme prej 1,635.92 euro si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumë prej 254 të gjitha këto në llogarinë e të autorizuarit të paditëses numër për Biznes brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të Aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi më datë: 14.09.2016 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurës për pagesën e pagave përcjellëse dhe pagave për shpërblim jubilar.

Gjykata me datë: 17.11.2017 ka mbajtur seancën kryesore në këtë çështje juridike, ku paditësja përmes të autorizuarit të saj në seancë deklaroi: se bënë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që në emër të një page jubilarë kërkojmë shumën prej 408.98 euro, ndërsa në emër të tri pagave përcjellëse shumën prej 1,226.94 euro ashtu që në total bëjnë 1,635.92 euro si dhe shpenzimet e përgjithshme në shumë prej 254 euro ku janë përfshirë përpilimi i padisë, një përfaqësim si dhe taksë gjyqësore.

Përfaqësuesja e të paditurës në seancë deklaroi se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditëses, meqenëse kërkesat e paditëses janë në pajtim me marrëveshjen e përgjithshme kolektive.

Meqenëse pala e paditur tani nuk e kundërshtoi kërkesëpadinë por e pohoi një gjë të tillë gjykata konform dispozitave ligjore mori aktgjykim në bazë të pohimit, pasi që nuk bëhej fjalë për kërkesë me të cilat palët nuk mund të disponojnë siq parashihet me nenin 3.3 të LPK-së.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,

C.nr.513/16 Me dt.17.11.2017.

**GJYQTARI,
Faton Ademi**



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palë e pa kënaqur ka te drejt ankese në afat 15 ditor, Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.